



Firmosja e marrëveshjes : z-nja Korin Fere, Zëvendës Kryetare e Rajonit të Normandisë së Poshtme dhe z. Nevzat Bejta, Ministër i Vetëqeverisjes Lokale. (në këmbë) z-nja Biljana Zasova, Zëvendës Drejtore e ALDA – Shkup, z-nja Ivana Dimitrovska, Udhëheqëse e Zyrës së ALDA Shkup, z. Aleksandër Folo, Drejtor i Sektorit për Çështje Evropiane dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare/Rajoni i Normandisë së Poshtme, z-nja Sabin Gisle Lebaji, Udhëheqëse e Departamentit për Bashkëpunim të Decentralizuar/Rajoni i Normandisë së Poshtme, z. Oriano Otočan, Kryetar i Shoqatës së Agjencive për Demokraci Lokale (ALDA), Kryetar i Shoqatës së Agjencive për Demokraci Lokale, z. Paskal-Emanuel Gale, Atashe për Bashkëpunim Rajonal pranë Ambasadës së Francës në Shkup, z. Zhan-İv Lavoar, Drejtor i IFS, E.T. i Zhan Klod Shlumberzhe, Ambasadori i Francës



Programi për Bashkëpunim të Decentralizuar Normandisë së Poshtme / Maqedonisë



Bashkëpunimi i Decentralizuar mes Normandisë së Poshtme dhe Republikës së Maqedonisë

Programi për Bashkëpunim të Decentralizuar mes Normandisë së Poshtme dhe Republikës së Maqedonisë ka për qëllim kryesor të kontribuojë mbi zhvillimin e qeverisjes së drejtë lokale dhe zhvillimin e baraspeshuar rajonal në dy territoret. Ky bashkëpunim realizohet me anë të shkëmbimeve të praktikave të mira në shumë fusha mes aktorëve të ndryshëm si pushteti lokal, shoqata të qytetarëve, institucione arsimore dhe sektori privat.

www.bn-mk.org

Bashkëpunimi mes Maqedonisë dhe Normandisë së Poshtme vazhdon

Zëvendës kryetarja e Rajonit të Normandisë së Poshtme, z-nja Korin Fere dhe Ministri për Vetëqeverisje Lokale, z. Nevzat Bejta kanë firmosur marrëveshje për bashkëpunim të decentralizuar mes Këshillit Rajonal të Normandisë së Poshtme dhe Republikës së Maqedonisë më 4 korrik 2012 në Shkup. Bëhet fjalë për rinovimin e marrëveshjes së firmosur në vitin 2009 ku dy palët përkushtohen për përf forcimin e bashkëpunimit gjatë katër viteve të ardhshme. Marrëveshja ishte firmosur në praninë e ekselencës së tij Ambasadorit të Francës në Maqedoni, z. Zhan Klod Shlumberzhe dhe kryetarit të Shoqatës së Agjencive për Demokraci Lokale (ALDA), koordinatori i programit, z. Orijano Otočan.

Ceremonialit të firmosjes i paraprinte një takim mes Ministrin dhe Zëvendës Kryetares. Ministri theksoi që aktivitetet e Normandisë së Poshtme në Maqedoni janë me rëndësi të madhe, posaçërisht në pjesën e decentralizimit dhe zhvillimit të barabartë rajonal që është një pjesë e rëndësishme për Maqedoninë. Vërtetë është me rëndësi për njësitë e vetëqeverisjes lokal të zhvillojnë kapacitete e tyre me anë të projekteve ndërkombëtare për integrim evropian të shtetit.

Me marrëveshjen u konfirmua interesi i dy palëve për zhvillimin e programit për bashkëpunim. Aktivitetet e parashikuara zhvillohen në bazë të projekteve të zbatuara në gjashtë fursha: teknologji të reja dhe të drejta të njeriut, të rinj, kulturë, inventarizim të trashëgimisë kulturore, turizëm dhe bujqësi. Faza e dytë e programit do të përfundojë në tetor 2013. Partnerët e përfshirë në bashkëpunimin vetëm më janë përgatitur për një fazë të tretë të programit prej 2013-2016. Vëmendje të posaçme do të përkushtohet mbështetjes institucionale gjatë procesit të decentralizimit dhe zbatimit të politikave për zhvillim të barabartë rajonal me anë të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të Rajonit me Ministrinë.



Z-nja Korin Fere dhe z. Nevzat Bejta

6 boshte të bashkëpunimit

1 Teknologji Digjitale

- Drejtoria për Zhvillim Digjital në Territorin e Këshillit Rajonal të Normandisë së Poshtme (FR)
- Metamorphosis (MK)

2 Rinia, Qytetari Lokale dhe Evropiane

- Shtëpia Evropiane – Normandi e Poshtme (FR)
- Koalicioni i Organizatave Rinore – SEGA (MK)

3 Inventarizimi i trashëgimisë kulturore

- Shoqata Kombëtare e Qyteteve me Histori dhe Art dhe Qytete me Zona dhe Sektorë të Mbrojtura (FR)
- Shoqata e Qyteteve nga Maqedonia me Trashëgimi Arkitektonike (MK)

4 Politika Kulturore

- Qendra Rajonale për Kulturë, Etnologji dhe Teknikë në Normandi të Poshtme - CRÉCET (FR)
- Qendra për Iniciativa të Reja në Kulturë – Lokomotiva (MK)

5 Turizmi

- Qendra për Zhvillim Institucional (CIRa), Maqedoni

6 Zhvillimi i bujqësisë

- Fermerët francez për zhvillim ndërkombëtar - AFDI Normandi e poshtme (FR)
- Federata e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë - FFRM (MK)



7 vëllazërimi i qyteteve

- Ohër (MK) - Caen (FR)
- Dibrë (MK) - İfis (FR)
- Berovë (MK) - Livarot (FR)
- Strugë (MK) - Ouistreham (FR)
- Veles (MK) - Cherbourg (FR)
- Vevčanë (MK) - Hermanville (FR)
- Krushevë (MK) - St. James (FR)